

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE GJILAN-DEGA NË VITI**, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, si gjykatë kontestimore e shkallës së parë, sipas gjyqtarit Nexhat Aliu me sekretaren juridike Azize Rama, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit S. G.(M.) nga Kllokoti, te cilin me autorizim e perfaqeson av A. I. e kundër të paditurve S. H. ( H.) nga fsh. Zh... K,Viti dhe M. M. (S) ish nga Kllokoti me adrese te panjohur të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm av. M.A. nga Vitia, baza e kontestit vërtetimi i pronësisë, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, me datë 18.07.2017, shpallë këtë;

## A K T G J Y K I M

**I. MIRATOHET** kërkesëpadia e paditësit S. G. (M.) nga Kllokoti, dhe **i njihet** e drejta e pronësisë në ngastren kadastrale nr.XXXX 1. Bujqsore, arë e klasës së dyt në sipërfaqe prej XXXX m2, 2. Bujqsore, arë , e klasit 3, në sipërfaqe prej XXX, me sipërfaqe të përgjithshme prej XXX m2 ne vendin e quajtur “ K...e V..” ZK..Kllokot e regjistruar ne emer te pronarit M.. M. (S.), nga Kllokoti, **në bazë të shitëblerjes.**

**DETYROHEN** te paditurit S. H. (H.) nga fsh Z.. K, Viti dhe M. M. (S) nga Kl., t’ia njohin të drejtën e pronësisë paditësit S. G. (M) nga K... dhe të durojne që ngastren e lartpërmendur t’i regjistrohet në emrin e paditësit.

**Ky aktgjykim** për Drejtorinë për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi të Komunës së Kllokotit, paraqet bazë, që në regjistrat kadastralë, të bëhet ndryshimi.

**II.**Shpenzimet e procedurës do t’i heq paditësi.

## A r s y e t i m

Gjykata të paditurin M. M. (S.) ish nga K... me adrese te panjohur, i kishte dërguar përgjigje në padi, por përgjigjjeja nuk ishte kthyer, sepse i padituri ishte e pamundur t’i gjindet adresa e vendbanimit apo vendqëndrimit, ne fletëkethese thuhej se i padituri ishte i panjohur. Gjykata kishte kerkuar edhe nepermes stacionit policor në Kllokot, që të sigurohet adresa e të paditurit por nga shkresa e policies thuhej se jeton diku në Sxxxx.

Në seancën përgatitore më datë xxxx, përfaqësuesi i paditesit S. G. (M.) av .A. I. ka deklaruar: mbetem ne teresi pran padis dhe kerkespadis se paditesit S. G. (M.) ndaj te paditurve te larteshenuar , paditesi S. G. (M.) ka blere nga i padituri i pare S.H.( H.) dhe ate ngastren nr.xxxx ne vendine e quajtur “K.. V..n” ne sipërfaqe prej xxxx m2 ZK Kllokot, si prove e kemi kontraten private mbi shitblerjen te dates xxxx e cila gjindet ne shkresat e lendes, ndersa i padituri i pare e kishte blere kete paluejtshmeri te larteshenuar nga i padituri i dyt qysh para 35 viteve te cilen e kishte shfrytezuar ne menyre te qete pa u penguar nga askush .

I padituri i pare S. H.. ka deklaruar:se kete ngaster babai im H. H. e ka blere para disa viteve , nga nje qytetar i nacionalitetit serb i cili ishte i K.. mirpo me vone është shperngulur diku ne Serbi , ne këte ngaster e kemi punuar me teper se xxx vite , ku ne vitin xxxx me date xxxx ja kam shitur paditesit S. G. M. nga K., ngastren ma ka paguar ne teresi dhe ka hyr ne posedim dhe shfrytezim pa u penguar nga askush. Dhe kerkoj Nga Gjykata qe t'ia njeh te drejten e pronesis paditesit pasi qe ngastren ma ka paguar ne teresi.

Perfaqesi i paditesi S. G. (M.) av.A. I. deklaroi: pasi qe i padituri i dyt M. M. (S.) mungon dhe nuk i dihet adresa e tij propozoj gjykates qe ti caktoj nje perfaqesues nga radha e avokateve per seancat e radhes per perfaqesim te tij deri ne perfundimin e kesaj qeshtje juridiko-civile.

Njiherit perfaqesuesi i paditesit i propozoi gjykates qe gjykata sebashku me ekspert te gjeodezise te daljen ne vendin e ngjarjes me qellim qe te behet identifikimi i ngastres xxxx ZK. K.....

Përfaqesuesi i perkoshem i te padituri M.M. (S) av.M. A. deklaroi:e kundërshtoj ne teresi padin dhe kërkespadin si te pa bazuar lidhur me bazueshmerin e kerkespadis, rezervoj te drejten te deklarohem pas admistrimit te gjitha provave ne seancat nuk e kundërshtoj propozimin e perfaesuesit te paditesit Av.A. I. per caktimin e ekspertit te gjeodezis si dhe daljen e Gjykates ne vendin e ngjarjes me qellim qe te behet identifikimi i asaj ngastre e cila ishte objekt i kerkes padis.

Me datën xxxx, Gjykata së bashku me ekspert të gjeodezisë, ka dalur në vendin e ngjarjes ne fsh.Kllokot , me qëllim të identifikimit të ngastrases nr.xxxx, e cilat ngastra për nga gjatësia shtrihet në Lindje-Perendim, ndërsa për nga gjerësia në Veri-Jug , e cila ngaster kadastrale me kultur eshte e mbjellur grur.

Perfaqesuesi i paditesi S. G. M. av.A. I. propozoj që për seancën e radhës të ndëgjohen dy dëshmitare qe kane njohuri lidhur me shitblerjen e kësaj ngastre.

Në seancën kryesore të dates;xxx, perfaqesuesi paditesit kishte mbetur pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke theksuar se ngastren kontestuese e ka blerë dhe e shfrytezon pa u penguar nga askush dhe e kishte paguar çmimin e kontraktuar dhe kishte hy ne posedim dhe shfrytzim pa u penguar nga askush. Po ashtu, perfaqesuesi i paditesit kishte propozuar të dëgjohen dëshmitarët MxMxx dhe Sxx Zx qe te dy nga Kxxxx.

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit av.M. A., nuk e kishte kundërshtuar propozimin e perfaqesuesit te paditësit për ndëgjimin e dëshmitarve.

Perfaqesuesi i paditesit S. G. (M.) Av.A. I. ka deklaruar pasi që kemi pranuar nga ana e Gjykatës, ekspertizen e ekspertit gjeodet nuk kemi vrejtje në ekspertizë.

Përfaqesuesi i perkoshem i të paditurit M.M. (S.) av.M. A.. ka deklaruar: pas pranimit të ekspertizës nga Gjykata të ekspertit gjeodet, nuk kishte vërejtje në ekspertizë.

Dëshmitari M. M.ka deklaruar : Këte ngaster qe po behet fjale sot ne gjykate e ka pas blere një qytetar i nacionalitetit shqiptar nga Zh.xx, para dikun xx viteve, serbet qe ja kan shitur kete ngaster ketij

shqiptarit të Zh...jan shperngulur per ne S..., para disa viteve. Ky shqiptar i Zh..... kete ngastër ja ka shitur G...dikun para xxxx viteve. Nuk kam ndegjuar qe mos te ja ket dhen te hollat shqiptarit ati serbit nga se në atë kohë ka qen e pamundur të hyre ne ate ngaster te cilen nuk e ke blerë, Ky shqiptari i Zh... kete ngaster e ka punuar me teper se xx viteve deri sa ja ka shitur Gxx,ku kete are tashti e punon Gxxx pa kurfar pengese.

Ne pyetjet e përfaqesuesi të përkoshem deshmitari është pergjigjur: Kam ndegjuar se jam fqinje i ketyre dhe njerzit kan treguar se është shitur ne ate kohe. Tashtë ajo shfrytezohet si are, edhe ne ate kohe eshte shfrytezuar si are, shitsi ka qen i knaqur nga se e ka shitur me vullnete.

2.Dëshmitari St.... Z...ka deklaruar:Këte ngaster te cilen e ka blere G... nga nje qytetar i nacionalitetit shqiptar, nga se shqiptari e ka blere para 45 vitet nga nje qytetari i nacionalitetit serb, serbet pas shitjes jan shpergulur ne S ,une nuk kam ndegjuar te jete ankuar ndokush nga serbet qe e kishin shitur para 45 vite, qe mos ti ken marr te hollat ne baze te qmimit te kontraktuar. Ata e kan punuar kete are shqiptaret qe nga koha e blerjes e deri tashti qe ja kan shitur G.... , tashti kete arë e punon G... , G...nuk ka kurfar problem ne lidhje me kete ngaster.

Ne pyetjen perfaqesuesit të përkoshëm dëshmitari pergjigjet; kam ndegjuar ngase me M.jemi fqinjet ateher eshte ditur kur eshte shitur ndonji arë, po ai ka qen i knaqur me qmimin e shitblerjes nga se ai ne ate kohe ka shitur gjithë token dhe oborrin dhe nuk eshte ankuar ma lidhur me ngastren.

Gjykata kishte lexuar dhe shtjelluar këto prova ; qerfitikata e pronese nr. xxxx e dt.xxx, ne emer te M. M. (S.), kontrata private mbi shitblerjes e patundeshmerise e lidhur me dt.xxxxxx.ne mes te Sx Hxri dhe Sx Gx pergjegjeja e AKP nr.xxxx/MB. e dt.xxxxxxxx ,pergjegjeja e stacionit policor ne Kllokot e dt.xxxx,ekspertizat e dt.xxxxx e perpiluar nga eksperti i gjeodezise T. N.

Perfaqesuesi i Paditësit S. G.b (M.) av.A. I. ne fjalen perfundimtare te paleve deklarone: mbetem ne teresi pran padise dhe kerkese padise, së paditesit S. G. nga Kllokoti ndaj te paditureve S.H. nga fsh.Zh... dhe M.q M.. tani me adrese te panjohur,

Paditesi ka blere nje ngaster nr.xxxxx ne vendin e quajtur "K... V.." me nje siperfaqe te pergjitheshme prej xxxx m2, ZK. Kllokot.

Paditesi që nga blerja e palujtshmerise e deri me sote e shfrytezon pa u penguar nga askush, po ashtu me daljen ne teren dhe identifikimin e ngastres kontestuese, pregaditjes se ekspertizes nga eksperti gjeodet si ne shkresat e lendes deklarimin e dy deshmitareve ne seancen e sotme kryesore si dhe provat tjera që gjinden ne shkresat e lendes konsideroi se jan te mjaftushme dhe bindese per gjykaten andaj edhe i propozoi gjykates që te bije nje aktgjykim te aprovohet kerkes padija e paditesit te larte shenuar dhe ti njihet e drejtja lidhur me paracellen si ne kerkese padi.

Përfaqesuesi i perkoshem i të paditurit M. M. (S.) av.M. A.ka deklaruar: pasë mbajtjes se disa seancave gjyqesore perkasishte daljës e gjykates ne vendin e ngjarjes dhe ndegjimin e dy deshmitareve ne seancen e sotme, eshte bërë administrimi i provave andaj i propozoi gjykates qe te vendos lidhur me kerkese padijen e paditesit S. G.(M.) ne baze te bindjes se lire dhe në baze te provave te prezentuara te vendos ne dispozitat ligjor qe jan ne fuqi.

Gjykata duke u bazuar ne nenin 8, të LPK-së, vlerësoi provat veç e veç dhe si tërësi..

Me leximin e çertifikatave së pronës, nr. xxxx e dt.xxxxxxxx, dhe ngastrës kontestuese nr.xxx, në emër të pronarit M. M. (S.), gjykata vërteton se padia përputhet plotësisht në subjektet si palë kontestuese.

Eksperiza e ekspertit të gjeodezisë, tregon përputhshmërinë e kërkesëpadisë në aspektin formal me gjendjen faktike në teren, si dhe gjendjen aktuale mbi shfrytëzimin e ketyre ngastrave kadastrale.

Deklaratat e dëshmitarve M. M. dhe S. Z. të dhëna në seancën e fundit të shqyrtimit gjyqësor, e forcojnë kërkesën e paditësit në njëërën anë dhe besimin e gjykatës për ekzistimin e punës juridike.

Gjykata ka vërtetuar se në mes të paditurve S. H. (H.) dhe M. M. (S.) dhe paditësit S.G.(M.) kishte ekzistuar raport juridik, i cili edhe pse jo i lidhur në formën e shkruar, ai ka prodhuar efekt juridik, me faktin se paditësi ka hy në posedim në të njëjten paluejtshmëri, të cilën edhe e mbanë më tej pa u penguar nga askush.

Gjykata për tërë këtë raport juridik mes palëve ndërgjyqëse u shërbye me të drejtën materiale e cila ishte në fuqi gjatë krijimit të këtyre raportëve, siç është neni 28, i LMD-së, sepse vullneti i palëve ka fuqi detyrimi dhe është mbi ligjin.

Andaj, gjykata duke u bazuar në gjitha këto prova dhe fakte të pakontestueshme, duke qenë e pavarur në vendosje miratoi kërkesëpadinë e paditësit.

Shpenzimet e procedurës do t'i bartë paditësi S. G. (M.) neni 453, i LPK-së.

Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË VITI**

**C.nr.241/2014**

**Më. 18.07.2017**

Sek. Juridike  
Azize Rama

Gj y q t a r i,  
Nexhat Aliu

**UDHËZIMI PËR MJETIN JURIDIK:** kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë, në afat prej 15 ditësh, pas ditës së pranimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.